





BASHKIA SHIJAK

RAPORTI I PERFORMANCES 2025





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK

Nr. 3344 Prot

Date 17.06.2026

BASHKIA SHIJAK

RAPORTI I PERFORMANCES

2025

Ky botim u mbështet nga 'Bashki të Forta', projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe Qeverisë së Suedisë, i zbatuar nga Helvetas. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Qeverisë së Zvicrës apo të Suedisë.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige



HELVETAS

Fjalor Shpjegues.....	4
Qëllimi i Raportit	7
Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë.....	7
Të Dhënat e Përgjithshme të Bashkisë	9
SHERBIME PUBLIKE VENDORE.....	10
 Arsimi Paraniversitar.....	10
 Menaxhimi i Mbetjeve.....	16
 Mbrojtja nga zjarri	19
 Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.....	21
 Administrimi i pyjeve dhe kullotave	23
 Mbrojtja Sociale.....	25
QEVERISJA E MIRE	28
 Burimet Njerëzore	28
 Transparenca.....	31
 Barazia Gjinore	33
EU Integrimi në BE.....	36
MENAXHIMI FINANCIAR	40
Përfundime dhe Rekomandime	44

FJALOR SHPJEGUES

Disagregim

Është procesi i ndarjes së të dhënave sipas kategorive të veçanta (si gjinia, mosha, vendbanimi urban/rural, tipi i institucionit publik/privat etj.) me qëllim që të kuptohet më mirë shpërndarja dhe ndikimi i një shërbimi ose fenomeni. Disagregimi ndihmon për të evidentuar pabarazitë, për të krahasuar grupet e ndryshme dhe për të planifikuar politika apo ndërhyrje më të drejtuara dhe gjithëpërfshirëse.

Funksion

Është fusha e veprimtarisë, për të cilën njësi e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencën ligjore për ta ushtruar lirisht, tërësisht apo në një pjesë të tij, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore

Nën-Tregues

Një nën-tregues është një element më i detajuar i një treguesi kryesor, që shërben për ta shpërbërë dhe matur më saktësisht një aspekt të veçantë të tij. Nën-treguesit ndihmojnë në kuptimin më të thelluar të performancës, duke dhënë informacion të ndarë sipas gjinive, zonave gjeografike, llojit të shërbimit (publik/privat) apo kriterëve të tjera të disagregimit.

Produkt

Një produkt i realizuar nga bashkia i referohet një të mire materiale ose shërbimi që ofrohet nga bashkia, e cila është përgjegjëse për ofrimin e shërbimit apo të mirës materiale. Bashkitë sipas ligjit janë përgjegjëse për ofrimin e një game të gjerë shërbimesh publike, si transporti, kanalizimi, furnizimi me ujë, menaxhimi i mbetjeve, shërbimet e mbrojtjes nga zjarri dhe asaj civile etj.

Qeverisja e Mirë

I referohet parimeve dhe praktikave që garantojnë funksionimin efikas, transparent, gjithëpërfshirës dhe të drejtë të një bashkie. Në këtë kuadër përfshihen elementë si transparenca publike, barazia gjinore, integrimi në BE, pjesëmarrja qytetare, profesionalizmi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i qëndrueshëm financiar.

Sistemi i Matjes së Performancës

Është mekanizmi kombëtar dhe vendor për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave mbi ofrimin e shërbimeve nga bashkitë. Ky sistem përfshin një grup treguesish dhe nën-treguesish të standardizuar, që përdoren për të krahasuar performancën e bashkive, për të rritur transparençën, llogaridhënien dhe për të mbështetur vendimmarrjen e bazuar në evidencë.

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 33, çdo bashki është e detyruar të krijojë një sistem të brendshëm matjeje dhe raportimi mbi performancën e saj, në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, përdorimin e burimeve dhe realizimin e objektivave. Ky sistem vendor lidhet ngushtë me sistemin kombëtar, duke mundësuar harmonizimin e të dhënave dhe krahasimin mes njërive të vetëqeverisjes vendore.

Sherbime Publike Vendore

Janë shërbimet që ofrohen nga bashkia për komunitetin, në përputhje me funksionet e përcaktuara nga ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Këto përfshijnë, ndër të tjera, , ndriçimin publik, arsimin parashkollor dhe çerdhet, mbrojtjen sociale, menaxhimin e mbetjeve, pyjeve e kullotave dhe ujitjen dhe kullimin etj. Sipas përkufizimit të ligjit “janë ato shërbime me interes të përgjithshëm publik, të cilat ofrohen për komunitetin nga bashkitë, në mënyrë të vazhdueshme, me çmime të përballueshme, sipas standardeve minimale kombëtare, të përcaktuara me ligj apo me akte të tjera normative’

Tregues performance

Një tregues i performancës është një matje që përdoret për të vlerësuar suksesin ose përparimin e një procesi. Mund të përdoret për të gjurmuar arritjet kryesore të performancës, të tilla si performanca financiare, kënaqësia e klientit, produktiviteti i punonjësve ose efikasiteti operacional, ose buxhetor / financiar dhe për të përcaktuar nëse synimet ose objektivat po përmbushen. Treguesit e performancës përdoren shpesh në sektorin privat por edhe ate publik dhe organizata të tjera për të ndihmuar menaxherët të marrin vendime të informuara, të identifikojnë fushat e përmirësimit dhe të masin performancën e përgjithshme të bashkisë.

Të Dhëna

Janë informacionet e mbledhura nga burime zyrtare të bashkisë ose institucione të tjera, që shërbejnë si bazë për llogaritjen e treguesve të performancës. Të dhënat mund të jenë numerike (statistika mbi popullsinë, buxhetin, shkollat etj.) ose cilësore (planifikime, raporte, dokumente strategjike) dhe janë të domosdoshme për analizën dhe raportimin e performancës.

Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

Taksat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhet sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

Transfertat e kushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

Transfertat e pakushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

Transferta e pakushtëzuar sektoriale

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

Trashëgimi nga viti i kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për çfarëdo zë apo projekt).

Si të lexojmë tabelën e performancës

Tabelat e treguesve në cdo fushe paraqesin ecurinë e treguesve të performancës për secilën fushë funksionale. Për çdo tregues jepen vlerat për dy vite, ndryshimi ndërvite, trendi, dhe semafori, të cilat ndihmojnë në interpretimin e rezultateve.

Kolona	Përshkrimi
Treguesi	Emri i treguesit që mat një aspekt të caktuar të performancës (p.sh. "Përqindja e konsultimeve publike të zhvilluara").
Njësia matëse	Tregon mënyrën se si matet treguesi (p.sh. %, numër, ha, lekë/frymë).
Vlera 2023 / 2024 /2025	Tregojnë rezultatet e arritura për secilin vit.
Ndryshimi (%)	Diferenca në përqindje ndërmjet viteve. Formula: $(\text{Vlera } 2025/2024 - \text{Vlera } 2023) / \text{Vlera } 2023 \times 100$.

Trendi dhe Simboli i Trendit
(→ ↑ ↓)

Diferenca në vlerë absolute ndërmjet viteve. (Vlera 2025
2024 – Vlera 2023). Simboli I Trendit tregon drejtimin e
lëvizjes: ↑ përmirësim, ↓ përkeqësim, → stabilitet

Semafori

Vlerësim vizual i nivelit të performancës: ● = vlerë
absolute ndryshimi pozitiv ● = vlerë absolute ndryshimi
negative.

Nota metodologjike mbi semaforin dhe interpretimin e treguesve

Në tabelat e performancës, ngjyra e semaforit llogaritet automatikisht sipas parimit të përgjithshëm “vlera positive ndryshimi = jeshile”. Kjo rregull zbatohet njëtrajtësisht për të gjithë treguesit dhe mund të japë vizualisht ngjyrë të kuqe edhe në raste kur rezultati real është pozitiv. **Në veçanti, për disa tregues me logjikë të përmbysur, ulja e vlerës absolute përfaqëson përmirësim të performancës. Këtu përfshihen, ndër të tjera:**

- Detyrimet e prapambetura (rënia tregon përmirësim financiar).
- Shpenzimet administrative (ulja tregon efikasitet).

Ne te tilla raste merret parasysh shpjegimi narrativ ne raport.

QËLLIMI I RAPORTIT

Raporti i Performancës 2025 synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar mbi performancën e bashkisë në dhjetë fusha funksionale. Ky raport përdoret për të ndihmuar vendimmarrjen e bazuar në të dhëna, për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien, si dhe për të mundësuar krahasimin ndërmjet bashkive në nivel kombëtar.

Ky raport është përgatitur nga Bashkia Shijak i mandatuar nga Kryetari i Bashkisë Z.Elton Arbana, në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, Neni 33, si dhe në kuadër të Sistemit Kombëtar të Matjes së Performancës (SMP 2025).

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI BASHKINË

Bashkia Shijak është pjese e Qarkut Durrës dhe përbëhet nga 4 Njësi Administrative(NjA): Shijak, Xhafzotaj, Maminas dhe Gjepalaj. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Shijakut. Qyteti është i organizuar në tre lagje, përkatësisht lagjia Popullore në pjesën më lindore të qytetit , lagjja Erzen në pjesën perendimore të qytetit dhe lagjia Kodra që pozicionohet në pjesën veriore të qytetit. Bashkia shtrihet në një zonë fushore dhe kodrinore përgjatë lumit Erzen dhe kufizohet në veri, perëndim dhe jug nga Bashkia Durrës (ndodhet vetëm 10 km larg qendrës së Durrësit) dhe në lindje nga Bashkitë Vorë dhe Tiranë (ndodhet 35 km larg Tiranës). Gjithë territori përshkohet nga lumi i Erzenit në një gjatësi prej 10 km. Bashkia ka një sipërfaqe prej 92.19 km2,

nga të cilat 3,5 km² e përbën qyteti i Shijakut. Bashkia Shijak sipas Censusit të vitit 2023 ka një popullsi prej 27,861 banorësh dhe me një densitet prej 302 banorë/km². Sipas Rregjistrit Civil numurohen 48,586 banorë ose 13,384 familje. Rreth 0.35% e familjeve sipas rregjistrit civil trajtohen me ndihme ekonomike.

Disa nga sfidat kryesore të zhvillimit janë:

Njësitë e qeverisjes vendore janë niveli i qeverisjes që qëndron më pranë qytetarëve dhe si të tilla ato i njohin dhe u shërbejnë më mirë nevojave të tyre dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së jetës. Njësitë e qeverisjes vendore kryejnë një sërë funksionesh bazuar në ligjin nr 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” të cilat detajohen konkretisht në nenet 23-30 të këtij ligji. Me qëllim kryerjen e këtyre funksioneve dhe ofrimin e shërbimeve publike vendore, bashkitë sigurojnë të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore, si dhe nga transfertat financiare në formën e transfertave ose granteve të kushtëzuara ose pakushtëzuara, nga nivelet e qeverisjes qëndrore. Mirëmenaxhimi i financave publike vendore është thelbësor për një qeverisje sa më të mirë. Qeverisja vendore kaloi në një proces decentralizimi duke synuar fuqizimin e saj dhe rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve që ajo ofron.

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË BASHKISË

E DHËNA	Census	Gjendja Civile
Popullsia totale nën administrimin e Bashkisë	27,861	48,586
Popullsia në zonën urbane	7,568	13,984
Popullsia në zonën rurale	20,293	34,502
Meshkuj në % kundrejt totalit të popullsisë së bashkisë	51.00%	52
Femra në % kundrejt totalit të popullsisë së bashkisë	49.00%	48
Familjet Gjithsej	6,965	13,384
Familje në zonën urbane	1,741	4,035
Familje në zonën rurale	5,224	9,349
Sipërfaqe totale e bashkisë në Km2	92	
Sipërfaqja urbane	4	
Njësia Administrative Shijak	4	
Sipërfaqja rurale	88	
Njësia Administrative Gjepalaj	32	
Njësia Administrative Maminas	23	
Njësia Administrative Xhafzotaj	33	
Sipërfaqe e tokës bujqësore në Ha	6,710	
Njësia Administrative Shijak	60	
Njësia Administrative Gjepalaj	2,504	
Njësia Administrative Maminas	1,954	
Njësia Administrative Xhafzotaj	2,192	
Kategoritë e tokës bujqësore në zonën rurale		
Sipërfaqe are	5,450	
Sipërfaqe pemëtore	584	
Sipërfaqe vresht	130	
Sipërfaqe e tokës Bujqësore e Ndare sipas 7501	4,974	
Nga kjo sipërfaqe e tokës bujqësore e kultivuar/bimore	3,864	
Rruge gjithsej në km linear	163	
Rurale	128	
Asfalt	84	
Te pashtuara	79	
Urbane	35	
Rrugë kryesore	5.7	
Rrugë dytësore	157.3	
Numri i bizneseve aktive	928	

SHERBIME PUBLIKE VENDORE

Ky kapitull paraqet performancën e bashkisë në ofrimin e shërbimeve publike vendore, të cilat përbëjnë thelbin e përgjegjësisë të saj sipas Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Në këtë kuadër, janë trajtuar gjashtë fusha kryesore të aprovuara edhe në kuadër të raportit kombëtar të performancës bashkiake, që përfshijnë gjithsej 10 funksione: arsimi parauniversitar (ku hyjnë çerdhet, arsimi parashkollor dhe infrastruktura e godinave arsimore), ujitja dhe kullimi, administrimi i pyjeve dhe kullotave, menaxhimi i mbetjeve, mbrojtja nga zjarri, mbrojtja civile, si dhe mbrojtja sociale, e cila përfshin katër shërbime të detyrueshme sipas nenit 24 të ligjit.

Matja e performancës në këto fusha bazohet në tregues të standardizuar sipas SMP Kombëtar, tregues të tjerë vendor që janë përzgjedhur nga bashkia, si dhe nën-tregues të detajuar, të cilët ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi aksesin e qytetarëve në shërbime, cilësinë dhe kapacitetet e tyre, si dhe barazinë në ofrim ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore. Përmes këtij sistemi, Bashkia ka mundësi të identifikojë përparimet e arritura, sfidat e mbetura dhe nevojat për përmirësim në ofrimin e shërbimeve themelore për komunitetin.

ARSIMI PARANIVERSITAR

Përshkrim i përgjithshëm: Arsimi parauniversitar në nivel vendor përfshin shërbimet e arsimit të hershëm (çerdhe dhe kopshte), arsimin bazë 9-vjeçar dhe arsimin e mesëm të përgjithshëm. Kompetencat për administrimin dhe zhvillimin e këtij sektori janë të deleguara te njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Dy funksionet kryesore që rregullojnë këtë fushë janë:

- Funksioni 23.11: “Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.”

Funksioni 23.12: “Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.”

Në këtë kuadër, bashkitë janë përgjegjëse njëkohësisht për aspektet infrastrukturore dhe menaxheriale të institucioneve arsimore nën juridiksionin e tyre. Kjo përfshin ndërtimin dhe mirëmbajtjen e objekteve shkollore (23.11), si dhe administrimin e plotë të sistemit parashkollor (kopshte dhe çerdhe) përmes funksionit 23.12, që përfshin menaxhimin e stafit ndihmës, mbështetjen logjistike dhe rregullimin funksional të shërbimit.

Analiza e performancës

Në aspektin e mirëmbajtjes së infrastrukturës arsimore, treguesit mbeten të qëndrueshëm dhe në nivel të plotë:

- çerdhe të mirëmbajtura: **100%**
- kopshte të mirëmbajtura: **100%**
- shkolla 9-vjeçare të mirëmbajtura: **100%**

Gjithashtu, numri i godinave arsimore mbetet i pandryshuar në **35 godina**, ndërsa nuk raportohen rikonstruksione të reja të shkollave apo kopshteve gjatë periudhës së analizuar.

Në arsimin bazë evidentohet rritje e lehtë e ngarkesës mësimore. Raporti nxënës/mësues në shkollat 9-vjeçare është rritur nga **9.56 në 10.15 nxënës/mësues** (↑ +6.23%), ndërsa numri mesatar i nxënësve për klasë është rritur nga **19.64 në 20.76 nxënës/klasë** (↑ +5.66%). Të dhënat burimore tregojnë rritje të numrit të nxënësve të regjistruar në arsimin bazë nga **1768 në 1868 nxënës**, ndërsa numri i mësuesve mbetet relativisht i qëndrueshëm.

Në arsimin parashkollor, numri mesatar i fëmijëve për klasë në kopshtet publike mbetet i pandryshuar në **15.83 fëmijë/klasë**, ndërsa raporti fëmijë-mësues në kopshte publike bie nga **13.97 në 5.89** (↓ -57.85%). Një rënie e ngjashme evidentohet edhe në kopshtet private, ku raporti bie nga **15.00 në 6.43** (↓ -57.14%).

Në arsimin e mesëm të përgjithshëm, numri mesatar i nxënësve për klasë ka rënë ndjeshëm nga **22.58 në 14.25 nxënës/klasë** (↓ -36.90%). Të dhënat burimore tregojnë rënie të numrit të nxënësve të regjistruar nga **542 në 342 nxënës**, ndërsa numri i klasave mbetet i pandryshuar në **24 klasa**.

Në drejtim të burimeve mbështetëse:

- punonjësit mbështetës për shkollat 9-vjeçare mbeten në **2.69 punonjës/shkollë**
- punonjësit mbështetës për shkollat e mesme mbeten në **2.50 punonjës/shkollë**



Nga pikëpamja financiare, raporti i shpenzimeve për institucionet e arsimit parauniversitar është rritur nga **2165.55 në 2672.79 mijë lekë/institucion** (↑ +23.42%), duke reflektuar rritje të mbështetjes financiare për sektorin arsimor.

Në sektorin e çerdheve, raporti i personelit të trajnuar kundrejt numrit total të personelit mbetet **100%**, ndërsa treguesi për çerdhet e furnizuara me material didaktik mbetet në **0%** gjatë gjithë periudhës së raportimit.

Treguesi për Planin Vendor të Arsimit Parauniversitar kalon nga **0 në 1**, duke reflektuar miratimin ose zbatimin e këtij instrumenti gjatë vitit 2025.

Vlerësim i përgjithshëm

Treguesit e arsimit parauniversitar në Bashkinë Shijak reflektojnë stabilitet në mirëmbajtjen e infrastrukturës arsimore dhe rritje të mbështetjes financiare për institucionet arsimore. Në të njëjtën kohë, evidentohet rritje e lehtë e ngarkesës në arsimin bazë dhe rënie e konsiderueshme e numrit të nxënësve në arsimin e mesëm të përgjithshëm. Gjithashtu, sektori paraqet nevojë për investime në materiale didaktike dhe për monitorim të mëtejshëm të treguesve të raportit fëmijë-mësues në arsimin parashkollor.



A) Lista e detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trend i	Simbo l	% Ndryshim i	Semafor
Tregues	Çerdhe të mirëmbajtura kundrejt numrit total të çerdheve publike	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Kopshteve të mirëmbajtura kundrejt numrit total të kopshteve publike	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Shkolla 9 vjeçare të mirëmbajtura, kundrejt numrit total të shkollave 9 vjeçare publike	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Raporti nxënës/mësues në shkolla 9 vjeçare	Nxënës /mësues	9.56	10.15	0.60	↑	6.23%	●
Tregues	Numri mesatar i nxënësve në një klasë të shkollës 9 vjeçare publike	Nxënës /klasë	19.64	20.76	1.11	↑	5.66%	●
Tregues	Numri mesatar i fëmijëve në një klasë kopshti publik	Nxënës /klasë	15.83	15.83	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Punonjës mbështetës për shkollë 9 vjeçare	punonjës mbështetës /shkollë 9 vjeçare	2.69	2.69	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Shkolla 9 vjeçare të rikonstruktura	numër	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Kopshte të rikonstruktura	numër	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Raporti i shpenzimeve për institucionet e arsimit parauniversitar kundrejt numrit total të institucioneve (Mijë Lekë/institucion)	Mijë Lekë /institucion	2165.55	2672.79	507.24	↑	23.42%	●
Tregues	Kopshte ku janë ngritur këshillat e prinderve kundrejt numrit total të kopshteve publike	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Punonjës mbështetës për shkollë mesme të përgjithshme	punonjës mbështetës /shkollë e mesme	2.50	2.50	0.00	→	0.00%	●

Tregues	Shpenzime kundrejt numrit total të studentëve të akomoduar në konvikte	Mijë Lekë/student	0.00	0.00	0.00		0.00%	○
Tregues	Numri mesatar i nxënësve në një klasë të arsimit të mesëm të përgjithshëm publik	Nxënës /klasë	22.58	14.25	-8.33	↓	-36.90%	●
Tregues	Numri mesatar i nxënësve në një dhomë në konvikt të arsimit profesional	Nxënës /dhomë konvikti	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Numri i konvikteve funksionale	numër	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Numri i prindërve të informuar në lidhje me prindërimin pozitiv për fëmijet 0-3 vjeç	numër	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Raporti i personelit të trajnuar kundrejt numrit total të personelit në çerdhe (në %)	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Raporti i çerdheve të furnizuara me material didaktik kundrejt numrit total të çerdheve (në %)	%	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Shkalla e regjistrimit në çerdhe publike	%	0.00	0.00	0.00		0.00%	○
Tregues	Shkalla e regjistrimit në kopshte publike dhe private	%	0.00	0.00	0.00		0.00%	○
Tregues	Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar	Po/Jo	0.00	1.00	1.00	↑	0.00%	●
Tregues	Raporti fëmijë-mësues në kopshte publike dhe private	nxënës/mësues	11.82	12.45	0.63	↑	5.37%	●
Tregues	Godina Arsimore sipas nivelit arsimor	numër	35.00	35.00	0.00	→	0.00%	●
Nëntregues	Raporti fëmijë-mësues në kopshte publike	nxënës/mësues	13.97	5.89	-8.08	↓	-57.85%	●
Nëntregues	Raporti fëmijë-mësues në kopshte private	nxënës/mësues	15.00	6.43	-8.57	↓	-57.14%	●

B) Shtojcë: Të dhënat burim

Kodi I të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D01	Numri I çerdheve publike të mirëmbajtuara	1	1	1	Numër
D02	Numri I kopshteve publike të mirëmbajtuara	17	17	17	Numër
D03	Numri I shkollave 9 vjeçare publike të mirëmbajtuara	13	13	13	Numër
D04	Numri I nxënësve të regjistruar në shkolla 9 vjeçare publike	1785	1768	1868	Numër
D05	Numri I mësuesve që japin mësim në shkolla 9 vjeçare publike	183	185	184	Numër
D06	Numri I klasave të kopshteve publike	30	30	30	Numër
D07	Numri I klasave të shkollave 9 vjeçare publike	90	90	90	Numër
D08	Numri i ndërtesave publike të arsimit bazë të rikonstruktura	0	0	0	Numër
D09	Numri i ndërtesave publike të arsimit parashkollor të rikonstruktura	0	0	0	Numër
D10	Numri i stafit mbështetës në arsimin bazë në shkollat 9 vjeçare publike	25	35	35	
D11	Shpenzime për insitucione publike të arsimit parauniversitar: çerdhe, kopshte, shkolla 9 vjeçare, shkolla të mesme të përgjithshme	78385	71463	88202	Mijë Lekë
D12	Numri i kopshteve publike ku janë ngritur këshillat e prindërve	17	17	17	Numër
D13	Numri i stafit mbështetës në shkolla të mesme të përgjithshme publike	5	5	5	Numër
D16	Numri I nxënësve të regjistruar në shkolla të mesme të pergjithshme publike	531	542	342	Numër
D17	Numri i klasave në shkolla të mesme të pergjithshme publike	24	24	24	Numër
D18	Numri i nxënësve të akomoduar në konvikte të arsimit profesional	0	0	0	Numër
D19	Numri i dhomave të konvikteve të arsimit profesional	0	641	587	Numër
D20	Numri i konvikteve funksionale	0	0	0	Numër
D21	Numri I prinderve te informuar ne lidhje me prinderimin pozitiv per femijet 0-3 vjec	0	0	0	Numër
D22	Numri i personelit të çerdheve publike	6	6	6	Numër
D23	Numri i personelit të trainuar të çerdheve publike	6	6	6	Numër

D24	Numri i çerdheve publike të furnizuara me material didaktik	0	0	0	Numër
D25	Numri i fëmijëve të moshës nga 6 muaj-3 vjeç në bashki				Numër
D26	Numri i fëmijëve të moshës 6 muaj deri në 3 vjeç të regjistruar në çerdhe publike	39	48	54	Numër
D27	Numri i fëmijëve të moshës nga 3–6 vjeç në bashki				Numër
D28	Numri i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç që frekuentojnë kopshtet publike	502	475	475	Numër
D29	Numri i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç që frekuentojnë kopshtet private	105	105	116	Numër
D30	Numri i edukatorëve në kopshte publike	57	55	57	Numër
D31	Numri i edukatorëve në kopshte private	7	7	7	Numër
D32	Numri i çerdheve publike në bashki	1	1	1	Numër
D33	Numri i çerdheve private në bashki	0	0	0	Numër
D34	Numri i kopshteve publike në bashki	17	17	17	Numër
D35	Numri i kopshteve private në bashki	2	2	2	Numër
D36	Numri i shkollave 9-vjeçare publike në bashki	13	13	13	Numër
D37	Numri i shkollave 9-vjeçare private në bashki	0	0	0	Numër
D38	Numri i shkollave të mesme të përgjithshme publike në bashki	2	2	2	Numër
D39	Numri i shkollave të mesme të përgjithshme private në bashki	0	0	0	Numër
D40	Plani vendor i Arsimit Parauniversitar, I miratuar ose zbatuar	0	0	1	Po/Jo

MENAXHIMI I MBETJEVE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë janë përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mbrojtjen e mjedisit në territorin e tyre. Ky funksion përfshin të gjitha aspektet që lidhen me mbledhjen, largimin, transportin, trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve, si dhe mirëmbajtjen e pastërtisë në hapësirat publike si rrugët, sheshet, tregjet dhe parqet. Nëpërmjet këtij funksioni, bashkitë sigurojnë krijimin dhe operimin e sistemeve vendore për menaxhimin e mbetjeve, duke përfshirë strukturat teknike, logjistikën, kontraktimin e subjekteve private dhe kontrollin e zbatimit të standardeve mjedisore.

Mbikëqyrjen dhe funksionimin e sistemeve për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve; Pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike (rrugë, parqe, tregje, kopshte publike); Dhënien e granteve ose fondeve për investime në infrastrukturën e mbetjeve; Monitorimin e ndotjes dhe

koordinimin me institucionet për mbrojtjen e mjedisit. Ky funksion rrjedh nga Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 23, i cili i njeh bashkive kompetencën për menaxhimin e shërbimeve publike vendore, përfshirë menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mirëmbajtjen e pastërtisë publike.

Analiza e performancës

Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve mbetet i pandryshuar në **87.50%** (→ **0.00%**) gjatë periudhës 2024–2025. Në mënyrë më të detajuar:

- mbulimi në zonat urbane mbetet **75%**
- mbulimi në zonat rurale mbetet **100%**

Të dhënat burimore tregojnë se shërbimi mbulon:

- **3 nga 4 njësi administrative qendër**
- të gjitha **26 fshatrat** e territorit të bashkisë.

Treguesi i mbetjeve të gjeneruara për frymë ka rënë nga **13.41 në 9.56 kg/banor** (↓ **–28.69%**), duke reflektuar ulje të sasisë së mbetjeve të raportuara gjatë vitit 2025. Të dhënat burimore tregojnë se sasia totale e mbetjeve të gjeneruara ka rënë nga **650,000 kg në 467,142 kg**.


Në aspektin financiar, mbulimi i kostos së menaxhimit të mbetjeve nga tarifa e shërbimit ka rënë nga **88.83% në 77.21%** (↓ **–13.08%**), duke reflektuar ulje të raportit ndërmjet të ardhurave të arkëtuara dhe kostove të shërbimit.

Megjithëse të ardhurat nga tarifa e shërbimit janë rritur nga **31,900 mijë lekë në 38,056 mijë lekë**, shpenzimet për ofrimin e shërbimit janë rritur në një nivel më të lartë, nga **35,912 mijë lekë në 49,291 mijë lekë**, duke ndikuar në uljen e nivelit të mbulimit të kostos.

Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve rezulton i miratuar ose në zbatim gjatë gjithë periudhës së analizuar (**1 → 1**), pa ndryshim ndërvite.

Vlerësim i përgjithshëm

Treguesit e menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Shijak reflektojnë stabilitet në mbulimin territorial të shërbimit dhe funksionimin e instrumenteve të planifikimit vendor. Në të njëjtën kohë, evidentohet rënie e sasisë së mbetjeve të raportuara për frymë dhe ulje e nivelit të mbulimit të kostove nga tarifa e shërbimit, si rezultat i rritjes së shpenzimeve operative të sektorit.



A) Lista e detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	2024	2025	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane/rurale	%	87.50	87.50	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Mbetjet e gjeneruara si kg/banor	kg/banor	13.41	9.56	-3.85	↓	-28.69%	●
Tregues	Mbulimi i kostos së menaxhimit të mbetjeve nga tarifa e shërbimit	%	88.83	77.21	-11.62	↓	-13.08%	●
Tregues	Plani vendor i menaxhimit të mbetjeve i miratuar ose në zbatim	Numër	1.00	1.00	0.00	→	0.00%	●
Nëntregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane	%	75.00	75.00	0.00	→	0.00%	●
Nëntregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat rurale	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	●

	mbetjeve në zonat rurale							
--	--------------------------	--	--	--	--	--	--	--


B) Shtojcë: Të dhënat burim

Kodi I të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D54	Numri njësive administrative qendër (qytete) të mbuluar me shërbimin e mbetjeve	3	3	3	Numër
D55	Numri njësive administrative qendër (qytete) të bashkisë	4	4	4	Numër
D56	Numri fshtrave të mbuluar me shërbimin e mbetjeve	26	26	26	Numër
D57	Numri fshatrave në territorin e bashkise	26	26	26	Numër
D58	Sasia e mbetjeve të gjeneruara gjithsej	640000	650000	467142	Kg
D59	Të ardhurat gjithsej nga tarifa e shërbimit të mbetjeve	22864	31900	38056	mijë Lekë
D60	Shpenzime gjithsej për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve	48790	35912	49291	mijë Lekë
D61	Plani i miratuar ose zbatuar gjatë vitit të raportimit	1	1	1	Cilësore (Po=1/Jo=0)
D52	Popullsia e përgjithshme e bashkisë	47502	48486	48865	Numër

MBROJTJA NGA ZJARRI

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë kanë përgjegjësi për garantimin e shërbimit zjarrëfikës në nivel vendor dhe për administrimin e strukturave përkatëse të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit. Ky funksion synon të sigurojë reagim të shpejtë dhe efektiv në raste emergjencash, si dhe të ndërtojë kapacitete vendore për parandalimin e zjarreve në mjedise urbane, rurale dhe pyjore. Përgjegjësitë e bashkive përfshijnë operimin dhe mirëmbajtjen e njësive zjarrëfikëse, organizimin e shërbimeve parandaluese, si dhe bashkëpunimin me strukturat qendrore për raste që tejkalojnë kapacitetet vendore. Bashkitë gjithashtu angazhohen në edukimin e komunitetit dhe

trajnimin e stafit për reagim dhe menaxhim të rreziqeve nga zjarret. Funksionimi dhe pajisja e njësive zjarrëfikëse dhe shërbimeve të emergjencës; Zbatimi i masave të parandalimit në ndërtesa publike dhe hapësira komunitare; Trajnimi i stafit vendor dhe vullnetarëve për ndërhyrje dhe evakuim; Mbështetja e fushatave sensibilizuese për komunitetin në lidhje me rreziqet nga zjarri.



A) Lista e detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	2024	2025	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Zjarrëfikës për 1,500 banorë	punonjës/1500 banorë	0.52	0.58	0.06	↑	11.18%	●
Tregues	Automjete zjarrëfikëse për 10,000 banorë	mjete/10000 banorë	0.82	0.82	0.00	↓	-0.52%	●
Nëntregues			0.00	0.00	0.00		0.00%	○

B) Shtojcë: Të dhënat burim

Kodi i të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D51	Numri i punonjësve zjarrëfikës në bashki	17	17	19	Numër

D52	Popullsia e përgjithshme e bashkisë	47502	48611	48865	Numër
D53	Numri i mjeteve zjarrëfikëse funksionale në bashki	3	4	4	Numër
D50	Numri i punonjësve për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor	16	16	16	Numër

MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT

Përshkrim i përgjithshëm: Funkcioni për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit është pjesë e kompetencave të deleguara të NJVV-të sipas Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 27 pika 1. Ky funksion përfshin ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ujitjes dhe kullimit në territorin e bashkisë, si dhe përgatitjen e planeve vendore për menaxhimin e qëndrueshëm të rrjeteve përkatëse. Qëllimi i këtij funksioni është mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm të prodhimit bujqësor dhe mbrojtja e konsumatorëve përmes garantimit të furnizimit me ujë për vaditje dhe menaxhimin të ujërave të tepërta në zonat bujqësore.

Analiza e performancës

Përqindja e tokës bujqësore të pajisur me kanale ujitjeje dhe/ose kullimi mbetet e pandryshuar në **69.64% (→ 0.00%)** gjatë periudhës 2024–2025. Nga një sipërfaqe totale prej **6,775.05 hektarësh tokë bujqësore**, rezultojnë të mbuluara me infrastrukturë ujitjeje dhe kullimi **4,718 hektarë**.

Në të njëjtën kohë, përqindja e përgjithshme e kanaleve ujitëse dhe kulluese funksionale është rritur lehtë nga **80.36% në 80.72% (↑ +0.44%)**, duke reflektuar stabilitet të përgjithshëm të funksionalitetit të rrjetit.

Në nivel të nën-treguesve:


- përqindja e kanaleve ujitëse funksionale është rritur nga **61.24% në 61.43% (↑ +0.32%)**
- përqindja e kanaleve kulluese funksionale mbetet në nivelin **100%**, pa ndryshim ndërvite.

Të dhënat burimore tregojnë se:

- gjatësia totale e kanaleve ujitëse mbetet **51.6 km**
- kanalet ujitëse funksionale rriten lehtë nga **31.6 km në 31.7 km**
- gjatësia totale e kanaleve kulluese mbetet **250 km**
- kanalet kulluese funksionale rriten nga **248.7 km në 250 km**, duke reflektuar funksionalitet pothuajse të plotë të rrjetit kullues.

Vlerësim i përgjithshëm

Treguesit e ujitjes dhe kullimit në Bashkinë Shijak reflektojnë stabilitet të infrastrukturës ekzistuese dhe nivel relativisht të lartë funksionaliteti të rrjetit të kanaleve gjatë periudhës 2024–2025. Evidentohet mbulim i konsiderueshëm i tokës bujqësore me infrastrukturë ujitëse dhe kulluese, si dhe funksionalitet pothuajse i plotë i rrjetit kullues.



A) Lista e detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	2024	2025	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Tokë bujqësore e pajisur me kanale ujitje/kullimi	%	69.64	69.64	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Përqindja e kanaleve ujitëse dhe kulluese funksionale	%	80.36	80.72	0.36	↑	0.44%	●
Nëntregues	Përqindja e kanaleve ujitëse funksionale	%	61.24	61.43	0.19	↑	0.32%	●

Nëntregues	Përqindja e kanaleve kulluese funksionale	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	
------------	---	---	--------	--------	------	---	-------	---

B) Shtojcë: Të dhënat burim

Kodi I të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D41	Sipërfaqja gjithsej e tokës bujqësore në bashki	6775.05	6775.05	6775.05	Hektarë
D42	Sipërfaqja e tokës bujqësore e mbuluar me kanale ujitje dhe/ose kullimi	4718	4718	4718	Hektarë
D43	Gjatësia e kanaleve ujitëse	51.6	51.6	51.6	Kilometër (km)
D44	Gjatësia e kanaleve ujitëse funksionale	31.6	31.6	31.7	Kilometër (km)
D45	Gjatësia e kanaleve kulluese	250	250	250	Kilometër (km)
D46	Gjatësia e kanaleve kulluese funksionale	249.5	248.7	250	Kilometër (km)

ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

Përshkrim i përgjithshëm : Funkcioni i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave, sipas nenit 27, pika 5 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i është deleguar bashkive me qëllim administrimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullosor publik që ndodhet brenda territorit të NJVV-ve. Bashkitë janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit për fondet, monitorimin e tyre dhe për sigurimin e mbrojtjes kundër dëmtimeve, ndotjes apo zjarreve, në përputhje me legjislacionin për pyjet dhe kullotat.

Analiza e performancës

Gjatë vitit 2025 evidentohet përmirësim i ndjeshëm në instrumentet e planifikimit dhe administrimit të fondit pyjor dhe kullosor. Treguesi për Planin Vendor të Mbarështimit kalon nga **0 në 1**, duke reflektuar miratimin ose zbatimin e planit gjatë periudhës së raportimit.

Në të njëjtën kohë, shkalla e pajisjes me plane mbarështimi rritet nga **0% në 100%**, duke reflektuar mbulimin e plotë të fondit pyjor dhe kullësor me plan mbarështimi gjatë vitit 2025. Të dhënat burimore tregojnë se nga një sipërfaqe totale prej **528 hektarësh**, e gjithë sipërfaqja rezulton e mbuluar me plan mbarështimi në vitin 2025.

Në aspektin e burimeve njerëzore, treguesi i punonjësve për 1,000 hektarë është rritur nga **3.79 në 5.68 punonjës/1000 ha** (↑ +50%), si rezultat i rritjes së numrit të punonjësve për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullësor nga **2 në 3 punonjës**.

Vlerësim i përgjithshëm

Treguesit e pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Shijak reflektojnë përmirësim të ndjeshëm në planifikimin dhe administrimin e fondit pyjor dhe kullësor gjatë periudhës 2024–2025. Evidentohet miratimi i Planit Vendor të Mbarështimit, mbulimi i plotë i fondit me plane mbarështimi dhe forcim i kapaciteteve njerëzore për administrimin e sektorit.

A) Lista e detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	2024	2025	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Plan Vendor Mbarështimi I miratuar ose zbatuar	Cilësore (Po/Jo)	0.00	1.00	1.00	↑	0.00%	●
Tregues	Shkalla e pajisjes me plane mbarështimi	%	0.00	100.00	100.00	↑	0.00%	●
Tregues	Punonjës për 1,000 hektarë	punonjës/1000 ha	3.79	5.68	1.89	↑	50.00%	●
Nëntregues			0.00	0.00	0.00		0.00%	○

B) Shtojcë: Të dhënat burim

Kodi i të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D47	Plan Vendor Mbarështimi I miratuar ose zbatuar	0	0	1	Cilësore (Po=1/Jo=0)

D48	Sipërfaqja gjithsej e fondit pyjor dhe kullosor në bashki	528	528	528	Hektarë
D49	Sipërfaqja e fondit pyjor dhe kullosor e mbuluar me plan mbarështimi	0	0	528	Hektarë
D50	Numri i punonjësve për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor	2	2	3	Numër

MBROJTJA SOCIALE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë janë përgjegjëse për krijimin, administrimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale vendore për individët dhe familjet në nevojë, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, fëmijët pa përkujdesje prindërore, të moshuarit, viktimat e dhunës dhe trafikimit, si dhe grupet e tjera vulnerabël. Shërbimet përfshijnë ndihma financiare dhe në natyrë, mbështetje për strehim dhe përfshirje sociale, si dhe funksionimin e qendrave ditore apo rezidenciale. Qëllimi i tyre është të lehtësojnë jetesën dhe të nxisin integrimin e qytetarëve në komunitet. Ndër shërbimet kryesore përfshihen: pagesat për kujdestari dhe lindje, ndihma për energji dhe nevoja bazë, shërbime për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara, mbështetje në kushte emergjente, strehim të përkohshëm dhe përkujdesje në shtëpi, si dhe masa për riintegrimin e të papunëve në tregun e punës. Bashkitë gjithashtu bashkëpunojnë me Organizata jo Fitimprurëse (OJF) dhe sektorin privat për ofrimin e këtyre shërbimeve në territor.

A) Lista e detajuar


Lloj	Emri	Njësia Matëse	2024	2025	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike	%	92.00	92.54	0.54	↑	0.58%	●
Tregues	Shkalla e miratimit të strehimit social	%	0.00	17.14	17.14	↑	0.00%	●
Tregues	Numri i qendrave sociale komunitare	qendra/10,000 banore	0.21	0.21	0.00	→	0.00%	●

	publike, te licensuara për 10,000 banorë							
Tregues	Përqindja e rasteve të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Përqindja e personave me aftësi të kufizuara, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	7.10	8.45	1.36	↑	19.14%	●
Tregues	Plan vendor social	Cilësore (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	0.00%	●

B) Shtojcë: Të dhënat burim

Kodi i të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D62	Numri i familjeve që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike	83	75	67	Numër
D63	Numri i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike	72	69	62	Numër
D52	Popullsia e përgjithshme e bashkisë	47502	48486	48486	Numër
D64	Numri i personave që kanë paraqitur kërkesë për strehim social	22	36	35	Numër
D65	Numri i personave përfitues të strehimit social	0	0	6	Numër
D66	Numri i qendrave sociale ditore funksionale	1	1	1	Numër

D67	Numri i qendrave sociale rezidenciale funksionale	0	0	0	Numër
D68	Numri i rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës të referuara nga Mekanizmit i Koordinuar i Referimit	24	20	22	Numër
D69	Numri i rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës të referuara nga antarët e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR), të cilat kanë përfituar shërbime sociale	24	20	22	Numër
D70	Numri i PAK të referuar nga shërbimet bio-psiko-sociale për të marrë shërbime sociale	400	451	485	Numër
D71	Numri i PAK që marrin mbështetje si pasojë e referimit	47	32	41	Numër
D72	Plani Vendor Social, i miratuar apo zbatuargjatë periudhës së raportimit	0	1	1	Cilesore(Po=1/Jo=0)



QEVERISJA E MIRE

Qeverisja e mirë përfaqëson aftësinë institucionale të bashkisë për të ushtruar përgjegjësitë publike me integritet, transparencë dhe efikasitet, duke garantuar përfshirjen qytetare dhe barazinë e mundësive. Në kuadër të matjes së performancës vendore, qeverisja e mirë vlerësohet përmes katër fushave përfaqësuese, të cilat reflektojnë cilësinë e proceseve të brendshme dhe kapacitetin administrativ për të siguruar rezultate të qëndrueshme:

1. Burimet Njerëzore – masin strukturën, stabilitetin dhe profesionalizmin e administratës vendore, si dhe nivelin e zhvillimit të kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve cilësore.
2. Transparenca – tregon nivelin e hapjes së informacionit dhe komunikimit me qytetarët, publikimin e akteve dhe respektimin e standardeve të qeverisjes së hapur.
3. Barazia Gjinore – reflekton përpjekjet institucionale për të siguruar përfaqësim të barabartë dhe përfshirje gjinore në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe politikëbërjes lokale.
4. EU Integrimi në BE – mat aftësinë e bashkisë për të përafruar praktikën e saj me standardet evropiane, përmes projekteve bashkëpunuese, partneriteteve ndërbashkiake dhe strukturave të dedikuara të integritetit..

BURIMET NJERËZORE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë kanë rol të rëndësishëm në menaxhimin e burimeve njerëzore për administratën vendore dhe strukturat e varësisë. Ky funksion përfshin planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit, si dhe ndjekjen e dinamikave të personelit – duke përfshirë rekrutimin, rotacionin, trajnimin dhe raportimin vjetor të të dhënave mbi stafin

aktiv dhe të larguar. Qëllimi është të sigurohet një trupë administrative efektive, e kualifikuar dhe në përputhje me nevojat e ofrimit të shërbimeve publike vendore. Përmes këtij funksioni, bashkia ndjek tregues si numri i punonjësve për 1,000 banorë, përqindja e stafit të trajnuar, si dhe lëvizjet vjetore të stafit sipas gjinisë dhe njësisë strukturore (administratë ose njësi shpenzuese).

Analiza e performancës

Shkalla e rotacionit të punonjësve të bashkisë është rritur nga **7.35% në 11.85%**, duke reflektuar rritje të nivelit të largimeve të stafit gjatë vitit 2025. Të dhënat burimore tregojnë se numri i punonjësve të larguar është rritur nga **25 në 41 punonjës**, ndërsa numri total i punonjësve në bashki është rritur nga **340 në 346 punonjës**.


Në të njëjtën kohë, përqindja e stafit të trajnuar ka rënë nga **12.94% në 8.09%**, duke reflektuar ulje të nivelit të përfshirjes së stafit në programe trajnimi gjatë periudhës së analizuar. Numri i punonjësve të trajnuar ka rënë nga **44 në 28 punonjës**.

Treguesi i punonjësve për 1,000 banorë është rritur lehtë nga **7.01 në 7.08 punonjës/1000 banorë**, duke reflektuar stabilitet relativ të raportit ndërmjet stafit dhe popullsisë së bashkisë. Popullsia totale e bashkisë është rritur nga **48,486 në 48,865 banorë** gjatë periudhës së raportimit.

Ndërkohë, bashkia nuk raporton punonjës të shërbimeve të nënkontraktuara, me treguesin që mbetet në **0** gjatë gjithë periudhës së analizuar.

Vlerësim i përgjithshëm

Treguesit e burimeve njerëzore në Bashkinë Shijak reflektojnë rritje të lehtë të numrit total të punonjësve dhe stabilitet të raportit staf/popullsi gjatë periudhës 2024–2025. Në të njëjtën kohë, evidentohet rritje e shkallës së rotacionit të stafit dhe ulje e nivelit të trajnimeve të punonjësve, çka sugjeron nevojën për forcimin e politikave të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë së burimeve njerëzore.



A) Lista e detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve të bashkisë	%	7.35	11.85	4.50	↓	61.16%	●
Tregues	Përqindja e stafit të punësuar nga bashkia të trajnuar	%	12.94	8.09	-4.85	↓	-37.47%	●
Tregues	Punonjës për 1000 banorë	punonjës/1,000 banorë	7.01	7.08	0.07	↑	0.98%	●

B) Shtojcë: Të dhënat burim

Kodi I të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D73	Numri i punonjësve në bashki gjatë vitit të raportimit	322	340	346	Numër
D74	Numri i punonjësve të larguar nga bashkia gjatë vitit të raportimit	28	25	41	Numër
D52	Popullsia e përgjithshme e bashkisë	47502	48486	48865	Numër
D75	Numri i punonjësve të trajnuar gjatë vitit	25	44	28	Numër
D76	Numri i punonjësve të shërbimeve të nënkontraktuara në bashki gjatë vitit të raportimit	0	0	0	Numër

☐ TRANSPARENCA

Përshkrim i përgjithshëm: Transparenca në pushtetin vendor është parimi që siguron që qytetarët të kenë qasje të lirë dhe të kuptueshme në informacionin publik, dokumentet zyrtare, si dhe proceset vendimarrëse të njësisë vendore. Ajo nënkupton publikimin e vendimeve, buxhetit, planeve dhe raporteve të ndryshme, duke mundësuar që qytetarët të jenë të informuar, të përfshihen në konsultime publike dhe të kërkojnë llogari nga institucionet lokale për veprimet apo mosveprimet e tyre. Transparenca forcon besimin mes qytetarëve dhe qeverisjes vendore, dhe ndihmon në parandalimin e abuzimeve apo korrupsionit.

Analiza e performancës

Treguesi për aktet për të cilat është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik është rritur nga **42.86% në 100%**, duke reflektuar përmirësim të ndjeshëm në zhvillimin e konsultimeve publike për aktet e raportuara gjatë vitit 2025.

Të dhënat burimore tregojnë se:

- në vitin 2024 janë raportuar **7 akte**, nga të cilat konsultimi publik është zhvilluar për **3 akte**
- në vitin 2025 janë raportuar **3 akte**, dhe konsultimi publik është zhvilluar për të gjitha ato (**3 nga 3 akte**)

Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes mbetet i publikuar gjatë gjithë periudhës së analizuar (1 → 1), duke reflektuar vazhdimësi në raportimin institucional mbi transparencën dhe informimin publik.

Gjithashtu, Plani Vendor i Integritetit rezulton i miratuar ose në zbatim gjatë gjithë periudhës së raportimit (1 → 1), pa ndryshim ndërmjet viteve 2024 dhe 2025.

Vlerësim i përgjithshëm

Treguesit e transparencës dhe integritetit në Bashkinë Shijak reflektojnë përmirësim të ndjeshëm të konsultimit publik gjatë periudhës 2024–2025, si dhe vazhdimësi në zbatimin e instrumenteve të transparencës dhe integritetit institucional.

A) Lista e detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	2024	2025	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Akte për të cilët është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik	%	42.86	100.00	57.14	↑	1.33%	●
Tregues	Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes	Cilësore (Po=1/Jo=0)	1.00	1.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Plani Vendor i Integritetit	Cilësore (Po=1/Jo=0)	1.00	1.00	0.00	→	0.00%	●

Nëntregues			0.00	0.00	0.00		0.00%	○
------------	--	--	------	------	------	--	-------	---

C) Shtojcë: Të dhënat burim

Kodi I të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D77	Numri i akteve gjithsej për të cilat është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik	7	7	3	Numër
D78	Numri i akteve për të cilët është zhvilluar konsultimi publik	1	3	3	Numër
D79	Publikimi i raportit vjetor për transparencën	1	1	1	Cilësore (Po=1/Jo=0)
D80	Plani Vendor i Integritetit, i miratuar ose zbatuar gjatë periudhës së raportimit	1	1	1	Cilësore (Po=1/Jo=0)

 BARAZIA GJINORE

Përshkrim i përgjithshëm: Barazia gjinore në qeverisjen vendore është një element kyç për ndërtimin e institucioneve demokratike, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse. Ajo nënkupton jo vetëm balancën në përfaqësim midis grave dhe burrave në pozicione drejtuese, por edhe integrimin sistematik të perspektivës gjinore në të gjitha proceset vendimmarrëse, politikat publike dhe ofrimin e shërbimeve. Në këtë kontekst, bashkitë duhet të garantojnë: • pjesëmarrje të barabartë gjinore në strukturat vendimmarrëse dhe administrative; • buxhetim të përgjigjshëm gjinor (gender-responsive budgeting), sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi; • ofrim

shërbimesh që adresojnë në mënyrë të barabartë nevojat e ndryshme të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, në të gjithë diversitetin e tyre; • mekanizma për mbrojtjen nga diskriminimi gjinor, diskriminimi për shkak të përkatësisë së shumëfishtë (intersectional discrimination) dhe dhuna me bazë gjinore. Bashkitë janë të detyruara të raportojnë jo vetëm për përfaqësimin gjinor në pozicione kyçe, por edhe për masat e marra për të zbatuar barazinë gjinore në praktikë, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe angazhimet ndërkombëtare.

Analiza e performancës

Përqindja e grave në pozicionet vendimmarrëse (kryetare, zv.kryetare, administratore dhe anëtare në këshillin bashkiak) është rritur nga **14.29% në 28.57%** (↑ +100%) gjatë periudhës 2024–2025. Të dhënat burimore tregojnë se numri i grave në këto pozicione është rritur nga **1 në 2 gra**, ndërsa numri total i pozicioneve mbetet i pandryshuar në **7 pozicione**.

Në të njëjtën kohë, përqindja e grave në pozicione drejtuese të niveleve të ndryshme (të larta, të mesme dhe të ulëta) është rritur nga **52.63% në 56.25%** (↑ +6.88%). Megjithatë numri total i pozicioneve drejtuese bie nga **19 në 16 pozicione**, numri i grave në këto pozicione mbetet relativisht i qëndrueshëm (**10 → 9 gra**), duke ruajtur nivel relativisht të lartë të përfaqësimit gjinor në strukturat drejtuese të bashkisë. Ndërkohë, Bashkia Shijak nuk raporton Plan Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore, me treguesin që mbetet në vlerën **0 (Jo)** gjatë gjithë periudhës së analizuar.

Vlerësim i përgjithshëm

A) Lista e detajuar

Lloji	Emri	Njësia Matëse	2024	2025	Trendi	Simboli	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Përqindja e grave në pozicione: kryetare,	%	14.29	28.57	14.29	↑	100.00%	●

	zv.kryetare, anëtare në këshill bashkiak dhe administratore							
Tr eg ues	Përqindja e grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët) në bashki	%	52.63	56.25	3.62	↑	6.88 %	●
Tr eg ues	Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore	Cilësore (Po/Jo)	0.00	0.00	0.00	→	0.00 %	●

Treguesit e barazisë gjinore në Bashkinë Shijak reflektojnë përmirësim të përfaqësimit të grave në pozicionet vendimmarrëse dhe ruajtje të një niveli relativisht të lartë të grave në pozicione drejtuese gjatë periudhës 2024–2025. Në të njëjtën kohë, evidentohet mungesa e një Plani Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore.

B) Shtojcë: Të dhënat burim

Kodi i të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D81	Numri gjithsej i pozicioneve drejtuese në bashki (Kryetare/Kryetar Bashkie, zv.Kryetare/zv.Kryetar Bashkie, Administratore/Administrator, Anëtare/Anëtarë në Këshill Bashkiak).	7	7	7	Numër

D82	Numri i grave në pozicione drejtuese në bashki: Kryetare, zv.Kryetare, Anëtare në Këshill Bashkiak dhe Administratore	1	1	2	Numër
D83	Numri i pozicioneve drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët)	18	19	16	Numër
D84	Numri i grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët)	10	10	9	Numër
D85	Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore, i miratuar ose zbatuar gjatë periudhës së raportimit	0	0	0	Cilësore (Po=1/Jo=0).

EU INTEGRIMI NË BE

Përshkrim i përgjithshëm: Integrimi në Bashkimin Evropian nuk është vetëm një detyrë e qeverisjes qendrore, por një proces i përbashkët që përfshin të gjitha nivelet e administratës publike, përfshirë pushtetin vendor. Bashkitë luajnë një rol kritik në afërsimin me acquis communautaire dhe përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit, përmes politikave dhe shërbimeve që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve. Në këtë kuptim, bashkive u rekomandohet të:

- Ndërtojnë kapacitete administrative për të përthithur dhe zbatuar fondet e BE-së;
- Zhvillojnë plane vendore për përputhshmëri me politikat e BE-së në fusha si mjedisi, energjia, digjitalizimi, barazia gjinore, migracioni, zhvillimi rural dhe përfshirja sociale;
- Fuqizojnë rolin e komuniteteve në procesin e integrimit përmes transparencës, pjesëmarrjes dhe ndërtimit të besimit publik.

naliza e performancës

Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara nga bashkia është rritur nga **0 në 1 marrëveshje**, duke reflektuar angazhim të ri në bashkëpunimin ndërinstitutional gjatë vitit 2025.

Treguesi për ekzistencën dhe funksionimin e strukturave të performancës në bashki mbetet i pandryshuar në vlerën **1 (Po)**, duke reflektuar funksionimin e strukturave të përfshira në organizimin funksional të bashkisë dhe strukturave të ngritura pranë drejtorisë së Integrimit Evropian sipas manualeve orientuese të AMVV-së.

Në lidhje me projektet e Bashkimit Evropian, treguesi për projektet e fituara kundrejt të aplikuara mbetet në nivelin **0%**, ndërsa të dhënat burimore tregojnë se gjatë vitit 2025 nuk raportohen aplikime për projekte të BE-së. Gjithashtu nuk raportohen projekte të fituara gjatë periudhës së analizuar.

Treguesi për Planet e Migracionit dhe Diasporës mbetet në vlerën **0 (Jo)** gjatë gjithë periudhës së raportimit, duke reflektuar mungesën e një plani vendor të miratuar ose në zbatim në këtë fushë.

Ndërkohë, Komisionet e Integrimit Evropian pranë Këshillit Bashkiak rezultojnë funksionale gjatë gjithë periudhës së analizuar, me treguesin që mbetet në vlerën **1 (Po)**.

Vlerësim i përgjithshëm

Treguesit e integrimit evropian në Bashkinë Shijak reflektojnë ekzistencën dhe funksionimin e strukturave institucionale të performancës dhe integrimit evropian, si dhe rritje të bashkëpunimit ndërbashkiak gjatë vitit 2025. Në të njëjtën kohë, evidentohet mungesë e aplikimeve dhe projekteve të fituara nga Bashkimi Evropian, si dhe mungesë e Planit Vendor të Migracionit dhe Diasporës.

Lloj	Emri	Njësi a Matëse	2024	2025	Trendi	Simboli	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara nga secila bashki	Numër	0.00	1.00	1.00	↑	0.00%	●
Tregues	Ekzistenca dhe funksionimi i strukturave të performancës në bashki	Cilësore (Po= 1/Jo=0)	1.00	1.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Projekte të fituara kundrejt të aplikuara nga bashkimi evropian (periudha 2-vjeçare 2023-2024)	%	0.00	0.00	0.00		0.00%	○

Tregues	Planet e migracionit dhe diasporës	Cilësore (Po=1/Jo=0)	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Komisionet e integritetit evropian pranë këshillave bashkiakë	Cilësore (Po=1/Jo=0)	1.00	1.00	0.00	→	0.00%	●


C) Shtojcë: Të dhënat burim

Kodi i të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D86	Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara	0	0	1	Numër
D87	Struktura e performancës e përfshirë në organizimin funksional të bashkisë	1	1	1	Cilësore (Po=1/Jo=0)
D88	Strukturat e performancës ngritur pranë drejtorisë së Integritetit Evropian sipas manualeve orientuese të AMVV-së	1	1	1	Cilësore (Po=1/Jo=0)
D89	Numri i projekteve të BE që bashkia ka aplikuar gjatë periudhës së raportimit			0	Numër
D90	Numri i projekteve të BE të fituara gjatë periudhës së raportimit				Numër

D91	Plani Vendor i Migracionit dhe Diasporës, i miratuar apo zbatuar gjatë periudhës së raportimit	0	0	0	Cilësore (Po=1/Jo=0)
D92	Komisionet e Integritetit Evropian pranë Këshillave Bashkiakë	1	1	1	Cilësore (Po=1/Jo=0)

MENAXHIMI FINANCIAR

Menaxhimi financiar është një funksion kyç për sigurimin e qëndrueshmërisë dhe eficiencës së qeverisjes vendore. Ai përfshin planifikimin, administrimin dhe raportimin e burimeve financiare të bashkisë, në përputhje me parimet e përgjegjshmërisë dhe transparencës. Në përmbushjen e këtij funksioni, bashkitë udhëhiqen nga kuadri ligjor për financat vendore, përfshirë Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Kjo kategori ndahet në tre fusha të veçanta që mbulojnë ciklin financiar: të ardhurat, shpenzimet, dhe buxheti. Vlerësimi i këtyre fushave ndihmon në monitorimin e kapaciteteve financiare të bashkive dhe në analizimin e performancës së tyre në përdorimin dhe menaxhimin e burimeve publike.



Analiza e performances

Të ardhurat e veta për frymë janë rritur nga 4,352.66 lekë/person në 5,806.24 lekë/person ($\uparrow +33.40\%$), duke reflektuar përmirësim të kapacitetit të gjenerimit të të ardhurave vendore gjatë vitit 2025. Të dhënat burimore tregojnë se të ardhurat e veta janë rritur nga 211,587 mijë lekë në 282,247 mijë lekë.

Në të njëjtën kohë, raporti i të ardhurave të veta kundrejt transfertave ka rënë nga 64.76% në 58.21% , duke reflektuar rritje më të lartë të transfertave në raport me të ardhurat vendore. Gjithashtu, raporti i të ardhurave të veta ndaj buxhetit ka rënë nga 39.31% në 36.79%, duke reflektuar ulje relative të peshës së të ardhurave vendore në strukturën e përgjithshme të buxhetit.

Shkalla e përdorimit të të ardhurave mbetet në nivelin 100%, pa ndryshim ndërmjet viteve 2024 dhe 2025, duke reflektuar përdorim të plotë të burimeve financiare të realizuara.

Të ardhurat nga taksa e pasurisë në raport me të ardhurat vendore kanë rënë lehtë nga 30.29% në 29.40%, megjithëse në vlerë absolute të ardhurat nga kjo taksë janë rritur nga 64,100 mijë lekë në 82,994 mijë lekë gjatë periudhës së analizuar.

Buxheti i miratuar për frymë është rritur nga 17,931.35 në 24,303.84 lekë/person ($\uparrow +35.54\%$), ndërsa shkalla e ekzekutimit të buxhetit është rritur nga 61.76% në 64.93%, duke reflektuar përmirësim të moderuar të realizimit të shpenzimeve të planifikuara.

Në drejtim të investimeve:

- investimet për frymë janë rritur nga 3,024.32 në 5,114.27 lekë/person ($\uparrow +69.11\%$)
- pesha e investimeve në buxhet është rritur nga 27.31% në 32.41%

Të dhënat burimore tregojnë se shpenzimet kapitale janë rritur nga 147,015 mijë lekë në 248,610 mijë lekë, duke reflektuar rritje të nivelit të investimeve publike gjatë vitit 2025.

Pesha e detyrimeve financiare të papaguara ndaj të tretëve mbetet në nivelin 0%, pa ndryshim ndërvite, duke reflektuar mungesë të detyrimeve të raportuara mbi 30 ditë gjatë periudhës së analizuar.

Në aspektin e strukturës së shpenzimeve:

- pesha e personelit në buxhet ka rënë nga 47.69% në 40.72%
- pesha e shpenzimeve operacionale është rritur nga 25.00% në 26.87%.

Vlerësim i përgjithshëm

Treguesit financiarë të Bashkisë Shijak reflektojnë përmirësim të nivelit të të ardhurave vendore, rritje të investimeve publike dhe përmirësim të moderuar të shkallës së ekzekutimit të buxhetit gjatë periudhës 2024–2025. Në të njëjtën kohë, evidentohet ulje relative e peshës së të ardhurave vendore kundrejt transfertave dhe rritje e peshës së shpenzimeve operationale në strukturën e buxhetit.


A) Lista e detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	2024	2025	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Të ardhurat e veta për frymë	leke/person	4352.66	5806.24	1453.58	↑	33.40%	●
Tregues	Të ardhurat e veta përkundrejt transfertave	%	64.76	58.21	-6.55	↓	-10.11%	●
Tregues	Raporti i të ardhurave të veta ndaj buxhetit	%	39.31	36.79	-2.51	↓	-6.39%	●
Tregues	Shkalla e përdorimit të të ardhurave	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Të ardhurat nga taksa e pasurisë ne raport me të ardhurat vendore	%	30.29	29.40	-0.89	↓	-2.94%	●
Tregues	Buxheti i miratuar për frymë	leke/person	17931.35	24303.84	6372.49	↑	35.54%	●
Tregues	Shkalla e ekzekutimit të buxhetit	%	61.76	64.93	3.17	↑	5.14%	●
Tregues	Investime për frymë	leke/person	3024.32	5114.27	2089.96	↑	69.11%	●
Tregues	Pesha e investimeve në buxhet	%	27.31	32.41	5.10	↑	18.67%	●

Tregues	Pesha e detyrimeve financiare të papaguara ndaj të tretëve	%	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Pesha e personelit në buxhet	%	47.69	40.72	-6.97	↓	-14.61%	●
Tregues	Pesha e shpenzimeve operacionale në buxhet	%	25.00	26.87	1.87	↑	7.48%	●
Nëntregues			0.00	0.00	0.00		0.00%	○

B) Shtojcë: Të dhënat burim

Kodi i të dhënës	E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D93	Të ardhurat e veta, fakt	217946	211587	282247	Mijë Leke
D52	Popullsia e përgjithshme e bashkisë	48486	48611	48611	Numër
D94	Transfertat gjithsej, fakt	450854	326728	484852	Mijë Leke
D95	Të ardhurat e përgjithshme, fakt	668800	538315	767099	Mijë Leke
D96	Totalit i shpenzimeve të bashkisë, fakt	668800	538315	767099	Mijë Leke
D97	Të ardhurat nga taksa e pasurisë, fakt	59096	64100	82994	Mijë Leke
D98	Shpenzime gjithsej, plan i rishikuar	903410	871661	1181434	Mijë Leke
D99	Shpenzime kapitale, fakt	200400	147015	248610	Mijë Leke
D100	Detyrime të papaguara mbi 30 ditë	136	0	0	Mijë Leke
D101	Shpenzime personeli, fakt	219535	256721	312375	Mijë Leke
D102	Shpenzime operacionale, fakt	248865	134579	206114	Mijë Leke



PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Arsimi Parauniversitar

Treguesit e arsimit parauniversitar në Bashkinë Shijak reflektojnë stabilitet në mirëmbajtjen e infrastrukturës arsimore dhe rritje të mbështetjes financiare për institucionet arsimore. Në të njëjtën kohë, evidentohet rritje e lehtë e ngarkesës në arsimin bazë dhe rënie e numrit të nxënësve në arsimin e mesëm të përgjithshëm. Rekomandohet vijimi i investimeve në infrastrukturën arsimore, forcimi i mbështetjes për arsimin parashkollor dhe monitorimi i ndikimit të ndryshimeve demografike në organizimin e rrjetit arsimor.

Menaxhimi i Mbetjeve

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve paraqet stabilitet në mbulimin territorial dhe funksionimin e instrumenteve të planifikimit vendor. Megjithatë, rritja e kostove të shërbimit ka ndikuar në uljen e nivelit të mbulimit financiar nga tarifa e shërbimit. Rekomandohet forcimi i eficiencës financiare të sektorit, përmirësimi i monitorimit të kostove operative dhe vijimi i masave për zgjerimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit.

Pyjet dhe Kullotat

Sektori i pyjeve dhe kullotave reflekton përmirësim të ndjeshëm në planifikimin dhe administrimin e fondit pyjor dhe kullor, me mbulim të plotë të territorit me plane mbarështimi

dhe rritje të kapaciteteve njerëzore. Rekomandohet vijimi i masave për monitorimin dhe zbatimin efektiv të planeve të mbarështimit, si dhe forcimi i kapaciteteve për mbrojtjen dhe administrimin e qëndrueshëm të fondit pyjor.

Bujqësia – Ujitja dhe Kullimi

Treguesit e bujqësisë dhe ujitjes reflektojnë nivel të lartë funksionaliteti të rrjetit kullues dhe stabilitet të infrastrukturës ekzistuese të ujitjes dhe kullimit. Rekomandohet vijimi i investimeve në mirëmbajtjen e rrjetit ujitës, rritja e eficiencës së përdorimit të infrastrukturës ekzistuese dhe forcimi i monitorimit teknik të rrjetit kullues dhe ujitës.

Burimet Njerëzore

Burimet njerëzore paraqesin rritje të lehtë të numrit të punonjësve dhe stabilitet të raportit staf/popullsi, ndërsa evidentohet rritje e rotacionit të stafit dhe ulje e nivelit të trajnimeve. Rekomandohet forcimi i politikave të zhvillimit profesional dhe trajnimit të stafit, si dhe përmirësimi i mekanizmave për ruajtjen dhe motivimin e burimeve njerëzore.

Transparenca dhe Integriteti

Fusha e transparencës dhe integritetit reflekton përmirësim të ndjeshëm të konsultimit publik dhe vijimësi në zbatimin e instrumenteve të transparencës institucionale. Rekomandohet vijimi i praktikave të konsultimit publik dhe forcimi i mekanizmave të komunikimit dhe përfshirjes qytetare në proceset vendimmarrëse.

Barazia Gjinore

Treguesit e barazisë gjinore reflektojnë rritje të përfaqësimit të grave në pozicionet vendimmarrëse dhe ruajtje të një niveli të lartë të përfaqësimit të grave në strukturat drejtuese të bashkisë. Në të njëjtën kohë, evidentohet mungesa e një Plani Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore. Rekomandohet hartimi dhe zbatimi i këtij plani, si dhe vijimi i masave për forcimin e përfaqësimit dhe integritetit gjinor në politikat vendore.

EU Integrimi Evropian

Fusha e integritetit evropian reflekton funksionimin e strukturave të performancës dhe integritetit, si dhe rritje të bashkëpunimit ndërbashkiak gjatë vitit 2025. Megjithatë, nuk raportohen aplikime apo projekte të fituara nga programet e Bashkimit Evropian. Rekomandohet forcimi i kapaciteteve për aplikim në programe të BE-së, si dhe zhvillimi i instrumenteve strategjike në fushën e migracionit dhe diasporës.

Menaxhimi Financiar

Menaxhimi financiar i Bashkisë Shijak gjatë periudhës 2024–2025 paraqet tendencë pozitive në drejtim të rritjes së të ardhurave vendore, investimeve kapitale dhe nivelit të realizimit të buxhetit. Rritja e investimeve për frymë dhe e peshës së investimeve në buxhet reflekton orientim më të madh të burimeve financiare drejt investimeve publike dhe zhvillimit vendor.

Në të njëjtën kohë, ulja relative e raportit të të ardhurave vendore ndaj transfertave dhe ndaj buxhetit tregon vazhdimësi të varësisë së bashkisë nga transfertat ndërqeveritare. Gjithashtu, rritja e shpenzimeve operacionale kërkon monitorim të vazhdueshëm për të ruajtur balancën ndërmjet shpenzimeve administrative dhe investimeve zhvillimore. Rekomandohet vijimi i masave për forcimin e bazës së të ardhurave vendore, rritjen e eficiencës fiskale dhe përmirësimin e planifikimit dhe monitorimit të investimeve kapitale. Gjithashtu, rekomandohet vijimi i kontrollit të shpenzimeve operative dhe ruajtja e nivelit të ulët të detyrimeve financiare të papaguara.

Konceptoi: Koordinatore për Performancën / Besmira Osmani

MIRATOI

KRYETARI

Elton Arbana

